



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 745/2 prot.

Tiranë, më 23. 05. 2022

V E N D I M

Nr. 94, datë 23 . 05 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr.78 Regj., datë 12.05.2022, të subjektit ankues S. H, kundër Bashkisë Kamëz, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar³”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të parashtruara nga subjekti ankues dhe dokumentacionit të depozituar, rezulton se, referuar Librezës “Për përfituesit e Statusit të të Verbërit”, me nr. 14484, datë 06.04.2018, të Shërbimit Social Shtetëror, ankuesja është përfituese e grupit të dytë (*Vendimi i KMCAP me nr. 1108*).

Ankuesja, në mes të tjerash informon se: “Jam e verbër, klasifikuar në grupin e dytë, banoj me pjesëtarët e tjerë të familjes, të cilët nuk kanë kontratë të energjisë elektrike. Edhe pse ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, më jep të drejtën e kompensimit të energjisë elektrike që unë shpenzoj, nuk e kam përfituar këtë shërbim nga Bashkia Kamëz, sepse nuk mund të paraqes një kontratë të energjisë elektrike, për shkak se kontrata e energjisë elektrike është në emër të pronarit të banesës. Gjithashtu nuk kemi as kontratë qiraje të banesës pasi nuk disponojmë. Unë kërkoj që ta përfitoj të drejtën e kompensimit të energjisë elektrike si e verbër dhe

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar Librezës “Për përfituesit e Statusit të të Verbërit”, me nr. 14484, datë 06.04.2018, të Shërbimit Social Shtetëror, ankuesja është përfituese e grupit të dytë (*cituar Vendimi i KMCAP me nr. 1108*).

të mos diskriminohem nga Bashkia Kamëz. Gjithashtu këtë të drejtë duhet ta përfitojnë të gjithë personat e verbër”.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për zbatimin e parashikimeve ligjore nga ana e Bashkisë Kamëz, si dhe ndryshimin e ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “*Për statusin e të verbërit*”, të ndryshuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si “*çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Neni 7 i LMD-së⁴, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “*Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim*”.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se: “*1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:*

⁴Shkurtesë për ligjin “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

...

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun...”

Me kërkesën e datës 17.04.2022⁵, ankuesja ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa e regjistruar pranë Zyrës së KMD-së me nr. 78 Regj., datë 12.05.2022.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94⁶/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, shtetasja S. H, e cila, me anë të kërkesës datë 17.04.2022, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se jemi në kushtet e nenit 90/3 dhe 94/1, të Kodit të Procedurave Administrative dhe për rrjedhojë procedura administrative për shqyrtimin e ankesës së S. H duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

⁵ Protokolluar pranë KMD-së, me nr. 786 prot., datë 20.05.2022.

⁶ “Tërheqja e ankesës”.

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 3, nenin 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 78 Regj., datë 12.05.2022, të subjektit ankues S. H, kundër Bashkisë Kamëz, për shkak se ankuesja është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: AK
Lloji i vendimit: Tërhequr nga ankesa